

5 MËNYRA SI TË “MBIJETOSH” NË GJIMNAZ

ARTIKULL

SHKRUAR NGA: BJORA SILAJ

Fundi i klasës së nëntë është një periudhë konfuzuese dhe irrituese, ku e vetmja gjë për të cilën mendon është e panjohura, gjimnazi. Ekzistojnë shumë të rinj që përhapin panik, mendime negative dhe pesimizëm në lidhje me këtë eksperiencë. Prandaj, kujtdo në këtë pozicion nevojitet orientimi dhe lehtësimi. Më poshtë do të rendis vetëm pesë mënyra si t'i "mbijetosh" gjimnazit, sepse edhe nëse nuk është një film i frikshëm, vazhdon të mbetet një vend kaotik.



1. Mbaje veten larg dramave

Nëse dëshiron të kesh një jetë të qetë e pa shqetësime të tepërta, duhet të qëndrosh larg dramave dhe situatave të pakëndshme që ndodhin në gjimnaz, pavarësisht se janë tunduese dhe vetë karakteri i moshës të shtyn të përfshihesh.

1. Lidh marrëdhënie të mira me mësuesit

Krijimi i marrëdhënieve të mira me mësuesit sjell mbështetje më të madhe nga sa e mendon. Pavarësisht pamjes së jashtme autoritare, mësuesit e gjimnazit kanë tendencën të bëhen miq shumë të mirë nëse ti përmbush disa kriteret e caktuara të qytetarisë të cilat varen nga mësuesit dhe nga vetë nxënësit.

1. Zgjidh cilësinë mbi sasinë

Nëse të duhet të zgjedhësh midis një rrethi të madh shoqëror dhe një rrethi të ngushtë miqsh, zgjidh gjithnjë opsionin e dytë. Pavarësisht gjithë argëtimit, mendimit perfekt të krijuar për grupet e mëdha shoqërore në të cilat ekziston një dashuri dhe harmoni e pafundme, shumica e rasteve kanë treguar se në to ekzistojnë konflikte, xhelozitë dhe inate të hesitura. Lindin drama të cilat të shtyjnë të kalosh stres dhe të prishësh paqen tënde të brendshme. Nga ana tjetër, një rreth i ngushtë miqsh karakterizohet nga njerëz të cilët ti i ke zgjedhur me kujdes dhe të cilët i vlerëson dhe të vlerësojnë për atë që je. Këta njerëz janë të atillë që të nxisin të mbrosh paqen tënde të brendshme, të rendësh drejt lumturisë dhe ëndrrave të tua dhe të punosh fort. Pikërisht për çfarë ka nevojë një adoleshent.

1. Qëndro pozitiv/e në momentet e vështira

Periudha e gjimnazit ka ulje-ngritjet e veta akademike, shoqërore e personale. Më e rëndësishmja është të ruash një mentalitet të fortë dhe pozitiv në momentet e vështira në mënyrë që ta shtypësh ti negativitetin përpara se negativiteti të të shtypë ty. More një notë negative? Nuk është fundi i botës. Do të punosh më fort herën pasardhëse dhe do të shkëlqesh. Grupi shoqëror në të cilin gjendesh të bën të ndihesh keq për veten dhe të pengon të jesh vetvetja? Jepi fund kësaj miqësie, sado e vështirë të jetë. Ti vlen më shumë se kaq dhe aty jashtë gjenden shumë njerëz që do të donin të kishin një mik/mikeshë si ti. Çdo gjë e ka një zgjidhje dhe çdo gjë ndodh në favorin tënd.

1. Mos lejo veten të biesh pre e tendencës për të krahasuar veten me të tjerët dhe për të qenë më IN pavarësisht dëshirave të tua

Në gjimnaz përballësh me shumë persona me interesa dhe preferenca të ndryshme që ndikojnë dashur padashur në botëkuptimin tënd. Në bazë të standardeve të krijuara nga shoqëria për adoleshentët cool ose perfekte, mund të ndihesh i humbur ose i përjashtuar. Ky është pikërisht momenti për t'i mposhtur këto mendime dhe për të përqaftuar vetveten me të gjitha ato që të karakterizojnë, mos ta krahasosh veten me të tjerët dhe të bësh vetëm ç'të fal lumturi dhe kënaqësi, pa menduar për të tjerët e për gjykimin e tyre. Bëhuni të fortë, të palëkundur dhe mbështeteni e duajeni fort veten tuaj. Gjimnazi është një det me dallgë, por marinarët më të mirë janë ata të trajnuarit në det të trazuar.